

AFATE

Komisioni mbledhet një herë në muaj, në varësi të kërkesave dhe problematikës së paraqitur. Data e mbledhjes dhe rendi i ditës, shoqëruar me materialet respektive, i vihen në dispozicion Komisionit të Posaçëm, të paktën, tri ditë kalendarike përpara ditës së mbledhjes.

Neni 4, pika 2 e Rregullores

Çdo dokumentacion aplikimi apo plotësime të tij, shqyrtohet brenda 2 ditë pune, nëse përmban ose jo, të plotë e të saktë gjithë dokumentacionin përkatës, sipas kësaj rregulloreje.

Neni 7, pika 7 e Rregullores

Për dokumentacionet e aplikimit, që rezultojnë jo në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, Sekretariati njofton, brenda dy ditë pune, subjektin aplikues, për mangësitë, nëpërmjet sistemit informatik të integruar, ose me shkresë zyrtare/njoftime verbale/postë elektronike/telefon.

Neni 9, pika 1 e Rregullores

Sekretari i Komisionit paraqet për shqyrtim, për mbledhjen e radhës të Komisionit, dokumentet e regjistruara, të paktën, deri 4 ditë pune para datës së mbledhjes dhe që kanë rezultuar në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Dokumentacioni i shoqëruar me material përmbledhës të hartuar nga Sekretariati Teknik i vihet në dispozicion anëtarëve të Komisionit në formë elektronike, 3 ditë pune përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e mbledhjes

Neni 8, pika 1 dhe 2 e Rregullores

Komisioni merr vendime, që kanë të bëjnë me licencimin e subjekteve që plotësojnë kërkesat për marrjen e licencës profesionale, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e aplikimit me dokumentacion të plotë, konform kësaj rregulloreje.

Neni 5, pika 1 e Rregullores